



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2081 / prot.  
2

Elbasan, me 22.09.2023

VENDIM

Nr 28 datë 22.09.2023

Për

**ndryshimin e Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 15, datë 03.05.2023 "Për miratimin e nivelit të pagave, për secilin pozicion pune, të personelit akademik në Universitetin e Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani'".**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", si dhe të Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar; Udhëzimit të përbashkët Nr. 20 datë 20.09.2019 të MASR dhe MFE " Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor"; VKM-së Nr. 75 datë 12.02.2018 "Për miratimin e modeli të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", VKM-n nr. 243, datë 20.04.2023 "Për disa ndryshime në VKM nr. 748 datë 11.06.2009 'Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë", Vendimit të Bordit të Administrimit Nr. 10 , datë 24.03.2023 "Për miratimin e planbuxhetit vjetor 2023" të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", i ndryshuar, Vendimit të Bordit të administrimit nr. 15, datë 03.05.2023 "Për miratimin e nivelit të pagave, për secilin pozicion pune, të personelit akademik në Universitetin e Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani'", Vendimit të Senatit Akademik nr. 18 datë 22.09.2023 "Për ndryshimin e Vendimit të Senatit Akademik nr. 9, datë 02.05.2023 "Për miratimin e nivelit të pagave, për secilin pozicion pune, të personelit akademik në Universitetin e Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani'", Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e nivelit të pagave (pa shtesën e vjetërsisë), për secilin pozicion pune, të personelit akademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" , sipas *Tabelës nr 1 kolona 10*.
2. Rritja e pagave mbi kufirin minimal të VKM-s nr. 243, datë 20.04.2023 "Për disa ndryshime në VKM nr. 748 datë 11.06.2009 'Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë'", është me efekt financiar mesatarisht 8.5% , *Tabela nr. 1, kolona 9*, ose në lekë, sipas strukturës së pagave pa shtesën e vjetërsisë *Tabela nr. 1, kolona 8*.
3. Efektet financiare të shtesës të fillojnë nga 01.09.2023 dhe të përballohen nga fondet e të ardhurave në dispozicion të miratuara për paga në planbuxhetin e vitit 2023
4. Ngarkohet Administratori i Universitetit "Aleksandër Xhuvani" për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT  
Dr. Ardian Durmishi

